



Projekti është financuar
nga Bashkimi Evropian



STUDIM FILLESTAR

PËR

TRENDET RINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

PËR NEVOJAT E PROJEKTIT

“PJESËMARRJA E TË RINJËVE PËR ZHVILLIM TË FUQISHËM DHE TË QËNDRUESHËM TË KOMUNITETIT”



„Младинско учество за силен и
одржлив развој на заедницата”



СЕГА
Кооперација на младински организации
www.sega.org.mk



**СОС ДЕТСКО
СЕЛО**
Многу малчуганци има потреба да рече нешто



forumi i gruas
женски форум
women's forum

TITULLI I ORIGJINALIT

ПОЧЕТНА СТУДИЈА ЗА МЛАДИНСКИТЕ ТРЕНДОВИ ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА ЗА ПОТРЕБИТЕ НА ПРОЕКТОТ „МЛАДИНСКО УЧЕСТВО ЗА
СИЛЕН И ОДРЖЛИВ РАЗВОЈ НА ЗАЕДНИЦАТА“

TITULLI I PUBLIKIMIT

Studimi fillestar i trendeve rinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për nevojat
e projektit “Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të
komunitetit”

PROJEKTI

Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të komunitetit

BOTUES

SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut

PËR BOTUESIT

Juliana Nakova Gapo, Drejtoreshë Kombëtare e Fshatit të Fëmijëve SOS Maqedonia e
Veriut

AUTOR

Sofija Georgievska

REDAKTORË

Tomislav Gajtanoski

Vaska Drashkoviç

PËRKTHIMI NË GJUHËN SHQIPE

Shoqëria për shërbime intelektuale dhe botim “Santo Stef – S”, Shkup

TIRAZHI

200 ekzemplar

DIZAJNI DHE SHTYPU

MAGNASKEN

Ky publikim është përgatitur me ndihmë financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e
tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet
e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
1. KORNIZA AKTUALE LIGJORE QË RREGULLON POLITIKAT DHE PJESËMARRJEN E TË RINJVE	6
2. QASJA METODOLOGJIKE	8
2.1. KORNIZA METODOLOGJIKE	8
2.1.1. Qëllimet e hulumtimit	8
2.1.2. Lënda e analizës	8
2.1.3. Metodologjia e hulumtimit	8
2.1.4. Mostra hulumtuese	10
3. ANALIZA E FUSHAVE TEMATIKE	12
3.1. KUALITETI I JETËS	12
3.2. ARSIMI	16
3.3. POLITIKA E TË RINJVE	18
3.4. PJESËMARRJA E TË RINJVE	21
3.5. SIGURIA	23
4. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KAPACITETEVE DHE QËNDRIMEVE TË ORGANIZATAVE QYTETARE	24
4.1. KAPACITETI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS	26
4.2. PUNA VULLNETARE E TË RINJVE NË BASHKËSI	28
4.3. POLITIKA RINORE	30
4.4. PJESËMARRJA E TË RINJVE DHE SEKTORIT RINOR NË JETËN PUBLIKE	32
5. PËRFUNDIME	38
6. REKOMANDIME	41
7. LITERATURA E PËRDORUR	43

HYRJE

Hulumtimi “Studimi fillestar për trendet rinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut” është realizuar për nevojat e projektit **“Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të komunitetit”**, i mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe i realizuar nga Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA në partneritet me SOS Fshatin e Fëmijëve Maqedonia e Veriut, Qendra Vullnetare Shkup dhe Shoqata Forumi i Gruas Tetovë. Projekti synon të përmirësojë cilësinë e zbatimit të politikave rinore bazuar në bashkëpunimin strukturor dhe pjesëmarrje thelbësore të shoqërisë civile të rrjetëzuar, duke krijuar një hapësirë për informimin e të rinjve, duke ofruar edukim joformal dhe duke krijuar përmbajtje rinore për të rinjtë.

Përmes këtij hulumtimi jepet një pasqyrë e dallimeve ekzistuese në perceptimet e të rinjve për cilësinë e jetës, mundësitë që të rinjtë kanë, si dhe mënyrat në të cilat të rinjtë bëjnë zgjedhjet që ndikojnë më shumë në të ardhmen e tyre si arsim, profesion dhe zhvillim personal dhe janë të lidhura me atë që ofron mjedisi i tyre. Hulumtimi bën një pasqyrë të sfidave më të mëdha me të cilat ballafaqohen të rinjtë në mjedise të ndryshme në nivel kombëtar, dhe përmes analizës së të dhënave të fituara, hulumtimi ndërton një pamje krahasuese të perceptimeve për mundësitë në jetën e të rinjve në vendbanimet më të vogla dhe më të mëdha në vendin tonë.

Të rinjtë e moshës prej 15 deri në 29 vjeç, të cilët janë target grupi i këtij hulumtimi, janë një kategori e qytetarëve që shteti rrallë i shikon të ndarë nga kategoritë e tjera të qytetarëve. Edhe kur bëhet fjalë për krijimin e politikave që synojnë të rinjtë, shteti më shpesh ka një qasje të unifikuar në vend që të vërë në perspektivë nevojat e të rinjve me prejardhje të ndryshme, si të rinjtë nga mjediset rurale dhe qytetet e vogla, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë nga familje me të ardhura të ulëta.

Duke pasur parasysh këtë, është e lehtë të supozohet se të rinjtë, përmes “masave” të të cilëve nuk vendosen politikat dhe zgjidhjet, kanë më pak zgjedhje kur bëhet fjalë për mundësitë arsimore, pastaj mundësitë për zhvillim dhe avancim personal, mundësitë për vetë-shprehje, si dhe pjesëmarrje në ngjarje kulturore.

Mungesa e politikave rinore të krijuara në mënyrë të duhur, në fushën e arsimit, punësimit apo mbrojtjes sociale, funksionaliteti i ulët i institucioneve, kontribuojnë në rritjen e shkallës së emigrimit të të rinjve nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Emigrimi, pakënaqësia, si dhe mungesa e komunikimit për përfshirjen aktive të të rinjve në proceset demokratike, janë pjesë e faktorëve që ndikojnë në amullinë e kapitalit social të të rinjve në vendin tonë gjatë dhjetë viteve të fundit¹. Mungesa e politikave, strategjive dhe dokumenteve moderne

¹ 10 години статус кво, Истражување за социјалниот капитал на младите, Младински образовен форум, 2020 година

që do të avancojnë pozitën e të rinjve, përmes përfshirjes efektive të tyre në vendimmarrje në procesin arsimor, në nivel lokal dhe kombëtar është diçka që është sfiduar ndër vite nga autoritetet arsimore, vendorre dhe autoritetet kombëtare.

Ndryshimet dhe përmirësimet e fundit në fushën e përfshirjes, konsultimit dhe aktivizimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse nga të rinjtë vihen re në valën e ndryshimeve të shkaktuara nga protestat e studentëve dhe të shkollave të mesme në periudhën 2014-2016. Kjo ishte baza për iniciimin e ndryshimit në përfshirjen sistematike të të rinjve në vendimmarrje brenda institucioneve të arsimit të lartë (përmes miratimit të Ligjit të ri për Arsimin e lartë), i parapriu krijimit të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore, si dhe rihapja e çështjes për ndryshime në Ligjin për arsimin e mesëm (që do të garantojë pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të mesme në vendimmarrje brenda shkollave dhe në procesin arsimor).

Një tjetër rrethanë e rëndësishme që ka ndikim serioz në gjendjen dhe pozitën e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kriza KOVID-19 që është përhapur në të gjitha segmentet e jetës shoqërore. Në këtë periudhë, të rinjtë ishin një nga grupet më të prekura të qytetarëve. Nisur nga ndryshimi i plotë i procesit arsimor, rëndimi serioz i pozitës (në përgjithësi) të të rinjve me aftësi të kufizuara², rritja e jostabilitetit ekonomik të të rinjve dhe mungesa e mbështetjes institucionale për të cilën të rinjtë kanë nevojë, janë vetëm disa nga sfidat që ka sjellë kriza për të rinjtë, dhe për të cilët ende nuk janë gjetur zgjidhjet e duhura të sistemit.³

Studime të shumta tregojnë se të rinjtë e përfshirë në aktivitete në bashkësinë lokale kanë përfitime të shumëfishta: psikologjike, sociale dhe kognitive. Nga ana tjetër, 90% e të rinjve në Maqedoninë e Veriut nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e ndonjë organizate qytetare/joqeveritare apo iniciative që punon në çështje shoqërore, ndërsa vetëm 20% e tyre mund të imagjinojnë në të ardhmen të bashkangjiten në ndonjë aktivitet të ndonjë organizate ose iniciative qytetare/joqeveritare.⁴ Gjithashtu, sipas Indeksit të zhvillimit të rinisë në Maqedoni, 76,1% e të rinjve asnjëherë nuk kanë qenë vullnetarë.⁵

2 Shih: „Влијанието на КОВИД-19 кризата врз лицата со попреченост во Северна Македонија“, Хелсиншки комитет за човекови права, 2021 година, <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/vlijanieto-na-kovid-19-vrz-licata-so-poprechenost.pdf>

3 Мë shumë në: „Млади во Криза“, МОФ, Реактор, ЗМАИ и група ГО, 2020 година: <https://mof.mk/wp-content/uploads/2021/07/Mladi-vo-kriza-2.0-Proshirena-verzija.pdf>

4 <https://mof.mk/wp-content/uploads/2021/07/WFD-26-FINAL-MK-za-web.pdf>

5 https://segaorg.mk/images/pdf/INDEX_MK.pdf

1. KORNIZA AKTUALE LIGJORE QË RREGULLON POLITIKAT DHE PJESËMARRJEN E TË RINJVE

Sipas kornizës ligjore, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pjesëmarrja e të rinjve nënkupton përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje që është vendimtare për ta, pjesëmarrje aktive e të rinjve duke gjeneruar ide dhe propozime për promovimin e pozitës së të rinjve në shoqëri si dhe qytetari aktive dhe kontribut në komunitet nga ana e të rinjve. Megjithatë, pjesëmarrja aktive në vetvete nuk do të thotë vetëm përfshirje në një aktivitet të caktuar, por është një proces në të cilin të rinjtë identifikojnë nevojat e tyre, kërkojnë zgjidhje, planifikojnë dhe zbatojnë aktivitete dhe kanë mundësinë të sjellin vendime në komunitetet dhe shoqërinë e tyre në tërësi. Ka shumë mënyra se si të rinjtë mund të marrin pjesë në vendimmarrje për çështje që janë të rëndësishme për ta dhe për komunitetin në tërësi. Format më të zakonshme të pjesëmarrjes së të rinjve që janë vërejtur në shoqëritë moderne evropiane janë këto⁶

- Punë vullnetare;
- Pjesëmarrja në forma të ndryshme të arsimit joformal;
- Edukimi i bashkëmoshatarëve - përfshirja e të rinjve në edukimin e bashkëmoshatarëve të tyre;
- Këshilla rinore, parlamente, forume dhe struktura të tjera - një mënyrë tradicionale e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes në suaza të autoriteteve ndërkombëtare, kombëtare, rajonale ose lokale, shkollave, klubeve, organizatave joqeveritare, etj.;
- Sistemet e bashkëmenaxhimit që ekzistojnë në disa institucione (për shembull, në Drejtorinë për rini dhe sport të Këshillit të Evropës), ku vendimet merren së bashku në bazë të barabartë me të rinjtë dhe zyrtarët e qeverisë;
- Konsultimet - përdoren në procesin e vendimmarrjes për të shprehur shqetësimet dhe nevojat dhe për të bërë sugjerime.

Disa zgjidhje ligjore përcaktojnë përgjithësisht pozitën e të rinjve në shoqërinë tonë, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar, si dhe brenda institucioneve arsimore.

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore⁷, i miratuar në vitin 2020, është zgjidhja e parë ligjore që garanton pjesëmarrjen e të rinjve dhe përshkruan dhe njeh format e shoqërimit dhe organizimit të të rinjve. Ky ligj rregullon çështjet lokale dhe kombëtare lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve, dhe

6 "Have your say!" - Manual on the Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life Council of Europe (2008), стр.21

7 <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

në këtë mënyrë hap detyrime për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve si në komuna ashtu edhe në institucionet kombëtare (Agjencia për rini dhe sport). Ky është ligji i parë që përcakton pjesëmarrjen e të rinjve në Maqedoninë e Veriut dhe garanton pjesëmarrjen e të rinjve përmes organeve të tyre përfaqësuese në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes që i influencojnë ata. Qendrat rinore të parashikuara dhe zyrtarët rinor janë mjet për kontakt të vazhdueshëm të të rinjve me institucionet. Ligji parashikon miratimin e strategjive lokale për rininë dhe një strategji kombëtare për rininë me kohëzgjatje prej 5 vjet, si dokumentet më të rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve rinore të planifikuara dhe të zbatuara nga institucionet.⁸

Ligji për Arsimin e Lartë⁹ i miratuar në vitin 2018 parashikon dhe garanton pjesëmarrjen e studentëve në menaxhimin e universiteteve. Kjo zgjidhje ligjore është e gjerë dhe rregullon çështjen në arsimin e lartë, por më e rëndësishmja në këtë kontekst është garantimi i asambleve të pavarura studentore që transmetojnë në mënyrë demokratike pikëpamjet dhe nevojat e studentëve në nivelet më të larta brenda universiteteve.

Pavarësisht pyetjes së hapur nga ana e organizatave qytetare dhe organeve përfaqësuese të nxënësve, në **Ligjin ekzistues për arsimin e mesëm**¹⁰ ende mungon rregullimi dhe garantimi i organizimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve në proceset vendimmarrëse në shkolla.

Është pothuajse e pamundur të mendosh për shoqërinë qytetare pa menduar për individët dhe grupet aktive që veprojnë mbi baza vullnetare. Puna vullnetare sot presupozon aktivitete të organizuara që kanë tre karakteristika: vullnetarizëm, mirëqenie të një personi tjetër ose mirëqenie të përgjithshme dhe ofrim falas i një shërbimi ose aktiviteti.¹¹ Puna vullnetare në vendin tonë është definuar në **Ligjin për punë vullnetare**.¹² Ai e përkufizon puna vullnetaren si ofrimin vullnetar të shërbimeve personale, njohurive dhe shkathtësive dhe/ose kryerjen e aktiviteteve të tjera në dobi të personave, organeve, organizatave dhe institucioneve të tjera, pa kompensim.

Duke pasur parasysh fotografinë e zgjidhjeve dhe propozimeve aktuale ligjore, është e qartë nevoja për mundësi për përfshirje të vërtetë demokratike të të rinjve, nevoja për të krijuar shërbime funksionale rinore, qendra rinore dhe mundësi për komunikim efektiv me institucionet arsimore dhe lokale.

Vetëm përmes monitorimit dhe dokumentimit të vazhdueshëm të situatës, përgatitjes së rekomandimeve dhe përfaqësimit para institucioneve me kërkesa

8 Më shumë në: Закон за младинско учество и младински политики, 2020 година <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

9 Më shumë në: Закон за високото образование <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20visokoto%20obrazovanie%20NOV.pdf>

10 <http://www.sonk.org.mk/documents/Zakon%20za%20sredno%20obrazovanie.pdf>

11 <https://www.unv.org/sites/default/files/UNV%20Issue%20Brief%20-%20Basic%20Services%20and%20Volunteering.pdf>

12 Më shumë në: Законот за волонтерство, јули 2007, Службен весник на РМ бр.85/2007 https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/precisten_tekst_volonterstvo.pdf

konkrete për të rinjtë mund të përmirësohet pozita e kësaj kategorie qytetarësh. Përveç kësaj, përmes këtyre qasjeve mund të punojnë për të reduktuar dallimet në mundësitë që të rinjtë kanë në mjedise të ndryshme, veçanërisht duke përmirësuar mundësitë e të rinjve në zonat rurale dhe qytetet më të vogla.

2. QASJA METODOLOGJIKE

2.1. KORNIZA METODOLOGJIKE

2.1.1. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të bëjë vlerësimin e nevojave, sfidave dhe rreziqeve të të rinjve nga të gjitha rajonet planifikuese, duke shqyrtuar perceptimet për cilësinë e jetës së të rinjve të përfshirë në mostrën e hulumtimit, në mënyrë që të identifikohen vlerat bazë fillestare të treguesve që do të përdoren për të monitoruar ecurinë e projektit.

Hulumtimi është kryer në lidhje me perceptimet e të anketuarve për: cilësinë e jetës, arsimin, politikën rinore, pjesëmarrjen e të rinjve dhe sigurinë e të rinjve.

2.1.2. Lënda e analizës

Lënda e analizës është përcaktimi i perceptimit të të anketuarve për nevojat, sfidat dhe rreziqet e të rinjve të moshës prej 15 deri në 29 vjeç në mjedise të ndryshme në të gjitha rajonet e vendit tonë.

2.1.3. Metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim bazohet në një kombinim të procedurave hulumtuese kuantitative dhe kualitative, me analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Më konkretisht, janë përdorur teknikat e mëposhtme të hulumtimit për mbledhjen e të dhënave:

- Rishikimi i literaturës;
- Fokus grupet
- Anketa online për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç, në një mostër të përshtatshme kombëtare, përmes platformës SurveyMonkey.
- Anketa online për organizata qytetare përmes platformës SurveyMonkey.

Dizajni i mostrës në këtë hulumtim është kryer sipas temës së hulumtimit dhe disponueshmërisë së të dhënave për përzgjedhjen e mostrës. Popullata e synuar në këtë hulumtim janë të rinjtë e moshës prej 15 deri në 29 vjeç dhe organizatat qytetare që punojnë për dhe me të rinjtë.

Hulumtimi me të rinjtë u realizua në një mostër prej 1050 të anketuar, në periudhën korrik - gusht të vitit 2021. Për këtë qëllim është krijuar një version dygjuhësh (në maqedonisht dhe shqip) i pyetësorit. Pyetësori për organizatat qytetare është plotësuar nga 61 organizata.

Të dhënat analizohen në nivel kuantitativ dhe kualitativ, duke përdorur metodat e mëposhtme hulumtuese:

- Metoda eksplorative;
- Metoda deskriptive;
- Metoda krahasuese;
- Metoda shpjeguese.

Të dhënat kuantitative të fituara nga hulumtimi anketues analizohen në nivel njëvariant, bivariant dhe multivariant, duke përdorur procedurat e duhura statistikore në SPSS, të cilat interpretohen tekstualisht dhe paraqiten vizualisht përmes fotografive, tabelave, grafikëve dhe diagrameve. Të dhënat kualitative nga fokus grupet e zbatuara analizohen në mënyrë narrative dhe përfshihen në analizën tematike të fushave.

Një nga kufizimet e hulumtimit është se ai u krye në format online gjatë pandemisë dhe nuk ishte e mundur të synoheshin plotësisht të rinjtë sipas një mostre të paracaktuar.

Anketa online përfshiu 1050 të anketuar, që është një mostër mjaft e madhe për të përcaktuar perceptimet për cilësinë e jetës tek të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe mostra është mjaft reprezentative që të mund të gjeneralizohet për të gjithë të rinjtë në vend. Hulumtimi është realizuar në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të gjitha 8 rajonet statistikore.

Megjithatë, jo të gjithë 1050 të anketuarit iu përgjigjën të gjitha pyetjeve. Të dhënat e mbledhura janë paraqitur përmes statistikave përshkruese, tabelave dhe fotografive, të cilat synojnë të përshkruajnë qartë të gjitha rezultatet, përfundimet dhe sygjerimet. Gjithashtu, në përputhje me thirrjen për hulumtim, është bërë një analizë desktop e legjislacionit kombëtar dhe hulumtimeve të mëparshme të bëra në këtë temë.


Në kuadër të pjesës kualitative janë realizuar tetë fokus grupe nga të gjitha rajonet planifikuese, duke përfshirë 69 të rinj:

Rajoni planifikues	Numri i pjesëmarrësve
Rajoni planifikues i Vardarit	4
Rajoni planifikues i Shkupit	7
Rajoni planifikues verilindor	12
Rajoni planifikues i Pollogut	10
Rajoni planifikues i Pellagonisë	11
Rajoni planifikues juglindor	9
Rajoni planifikues lindor	8
Rajoni planifikues jugperëndimor	8


2.1.4. Mostra e hulumtimit

Për nevojat e analizës janë plotësuar 1050 pyetësorë nga persona të moshës prej 15 deri 29 vjeç. 244 (23.2%) e personave janë meshkuj, 689 (65.5%) janë femra, 0.2% janë shprehur se ndjehen ndryshe dhe 11% preferojnë të mos përgjigjen në këtë pyetje.

Të anketuarit janë të ndarë në 3 grupmosha, në moshën prej 15 deri në 19 vjeç (N = 391), në moshën prej 20 deri në 24 vjeç (N = 351) dhe në moshën prej 25 deri në 29 vjeç (N = 185). Pjesa e mbetur (11.7%) e të anketuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Sa i përket nacionalitetit, mund të shohim se përqindjen më të madhe të mostrës e përbëjnë përfaqësuesit e nacionalitetit maqedonas (80,2%).



Kur bëhet fjalë për përkatësinë fetare, 67.7% e të anketuarve janë ortodoksë, 17.1% myslimanë dhe 7.0%% deklarojnë se nuk janë fetarë.




Të anketuarit gjithashtu kishin mundësinë të tregojnë nëse kanë ose jo aftësi të kufizuara, ku 38 të anketuar (4.1%) deklaruan se kanë aftësi të kufizuara, kryesisht shikim të dobët (15 persona) dhe mungesë vëmendjeje (9 persona).

	Frekuenca	Përqindja
Lëndim i fituar/traumatik i trurit	3	0.3
Çrregullimi i deficitit të vëmendjes/hiperaktivitet	9	0.9
Spektri i Aspergerit / Autizëm	2	0.2
Verbëri/ shikim të dobët	15	1.4
Shurdhim / Gjysmëshurdhëri	4	0.4
Pengesë kognitive ose në të mësuarit	1	0.1
Sëmundje kronike / gjendje mjekësore	5	0.5
Probleme të shëndetit mendor / gjendje psikologjike	6	0.6
Çrregullim fizik / gjendje lëvizshmërie që ndikon në ecje	3	0.3
Çrregullim fizik/gjendje lëvizshmërie që nuk ndikon në ecje	3	0.3
Çrregullim në të folurit / komunikim	9	0.9

Për sa i përket vendbanimit, mund të vërejmë se 81.3% e të anketuarve jetojnë në mjedis urban, 16.6% në mjedis rural.

Në suaza të mostrës tonë, pjesa më e madhe e të anketuarve, pra 1/3 (37.1%) janë studentë dhe nxënës të shkollave të mesme.



3. ANALIZA E FUSHAVE TEMATIKE

3.1. KUALITETI I JETËS


Grupi i parë i pyetjeve në kuadër të kësaj Analize i referohet disa aspekteve sociale që krijojnë kënaqësi, gjegjësisht pakënaqësi tek të rinjtë.

Është interesante se kënaqësinë më të madhe të rinjtë e krijojnë mundësitë për shprehje dhe mendim të lirë, regjistrim në fakultet dhe studime pasuniversitare.


Pakënaqësinë më të madhe e krijojnë mundësitë apo pamundësitë për punësim, pavarësia ekonomike, zgjidhja e çështjes së banimit dhe veprimi politik.

	Krijon kënaqësi	Krijon pakënaqësi	Nuk krijojnë as kënaqësi as pakënaqësi
Regjistrimi në shkollë të mesme	68,0%	3,5%	28,5%
Regjistrimi në fakultet	74,6%	5,3%	20,1%
Regjistrimi në studime pasuniversitare	74,2%	5,6%	20,3%
Mënyra e shkollimit	48,2%	27,0%	24,8%
Mundësi punësimi	52,2%	39,0%	8,8%
Mundësi për të zgjidhur çështjen e banimit	49,3%	35,2%	15,5%
Mundësi për pavarësi ekonomike	54,9%	34,1%	11%
Mundësi për të rinjtë të bëjnë atë që duan dhe atë që është e rëndësishme për ta	66,2%	22,1%	11,7%
Mundësi për avancim në profesion	68,7%	22,1%	9,2%
Mundësitë për veprim politik	24,9%	36,7%	38,4%
Mundësi për argëtim dhe relaksim	83,3%	8,9%	7,8%
Mundësi për shprehje të lirë të mendimit personal	76,8%	13,5%	9,7%

Edhe nëse merren parasysh të gjitha këto aspekte, standardi aktual i jetesës për 42,8% të të rinjve është mesatar, dhe për 32,9% është i mirë. Megjithatë, 10% e të rinjve kanë një standard jetese të dobët ose shumë të dobët.



Megjithatë, nëse do të bëhet një krahasim me tre vitet e fundit, cilësia e jetës për 39.8% të të anketuarve është përmirësuar.



Në një shkallë nga një deri në pesë, ku 1. do të thotë “shumë më keq”, 2. “më keq”, 3. “e njëjtë”, 4. “më mirë” dhe 5. do të thotë “shumë më mirë”, të anketuarit kishin mundësinë të vlerësojnë se si do të jetë cilësia e jetës së tyre në tre vitet e ardhshme. Përgjigjet janë brenda mesatares (se do të mbetet e njëjtë), por janë më optimistë për sa i përket të ardhurave dhe arsimimit që do të fitonin në tre vitet e ardhshme.

	M
Të ardhura	3.68
Statusi i punës	3.65
Arsimi dhe trajnimi	3.85
Mbrojtja shëndetësore	3.28
Strehimi	3.38

Gjithashtu, të anketuarit kishin mundësinë të vlerësojnë se si janë ndjerë në 3 muajt e fundit, ajo që jep shpresë dhe gëzim është se të anketuarit ndjehen të dashur dhe të sigurt në vete.

	M
Ndjehem optimist/e kur mendoj për të ardhmen	3.36
Ndjehem i/e dobishëm/me	3.55
Kam vetëbesim, ndjehem i/e sigurt në vetvete	3.79
Ndjehem i/e dashur	3.94
Ndjehem i/e disponuar	3.67
Ndjehem në stres (i/e shqetësuar)	3.25
Ndjehem i/e pikëlluar	2.51

Të rinjtë gjithashtu kishin mundësinë të rangojnë problemet me të cilat përballen të rinjtë dhe që i prekin më shumë ata. Nga tabela shihet se për 58.4% të të rinjve, papunësia vjen në rend të parë, pastaj vjen pavarësia materiale dhe ekonomike (50.8%), alkoolizmi, varshmëria nga droga, delikuenca e të ngjashme (45.9%) dhe sistemi arsimor (42.4%).

	1	2	3
1. Pavarësia materiale dhe ekonomike	50.8%	29.5%	19.7%
2. Sistemi arsimor	42.4%	35%	22.7%
3. Papunësia	58.4%	17.4%	24.2%
4. Problemet e strehimit	32.3%	41.7%	26%
5. Shfrytëzimi i kohës së lirë	20.9%	38.9%	40.2%
6. Pozita vartëse e të rinjve	22.3%	51.4%	26.2%
7. Kriza morale dhe mungesa e idealeve	34.7%	40.8%	24.5%%
8. Kujdesi i pamjaftueshëm i shoqërisë për problemet e të rinjve	41.9%	33.6%	24.4%
9. Dallimet sociale	36.1%	39.5%	24.4%
10. Mosmarrëveshjet kombëtare	35.3%	39.7%	25%
11. Mungesa e interesimit të të rinjve për problemet sociale	30.9%	42%	27.1%
12. Mosefikasiteti dhe mosaktiviteti i organizatave rinore	27.5%	43.3%	29.2%
13. Mungesa e lirisë së fjalës dhe mendimit	41.6%	33.3%	25.1%
14. Alkoolizmi, narkomania, delikuenca dhe të ngjashme	45.9%	28.6%	25.5%
15. Tjetërsimi i marrëdhënieve njerëzore	40.3%	35.5%	24.1%

Zhgënjyes është fakti se pothuajse gjysma e të të rinjve nuk kanë dëgjuar për Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, nga 16 qëllimet e dhëna, si më të rëndësishme të rinjtë i vënë në pah shëndetin dhe mirëqenien, si dhe paqen, drejtësinë dhe institucionet e forta, dhe më pak të rëndësishme janë konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm dhe partneriteti për qëllime.

	Përqindja
Një botë pa varfëri	25.6
Një botë pa uri	20.7
Shëndet dhe mirëqenie	41.2
Arsim cilësor	27.0
Barazia gjinore	11.5
Ujë të pastër dhe kushte sanitare	9.1
Energjia e disponueshme nga burime të pastra	4.5
Punë të denjë dhe rritje ekonomike	22.5
Industria, inovacioni dhe infrastruktura	5.0
Reduktimi i pabarazisë	9.0
Qytete dhe komunitete të qëndrueshme	3.8
Konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm	2.4
Mbrojtja e klimës	6.8
Ruajtja e botës ujore	3.6
Ruajtja e jetës në tokë	14.7
Paqe, drejtësi dhe institucione të forta	32.0
Partneritet për qëllime	2.1

3.2. ARSIMI

16

Pjesa e dytë e kësaj analize trajton temën e arsimit. Të anketuarit kishin mundësinë të vlerësojnë se sa arsimi që kanë marrë ose që po e marrin do t'u mundësojë atyre të punësohen në të ardhmen në fushën e arsimit dhe janë përgjigjur në shkallën prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë jo aspak, dhe 5 do të thotë Plotësisht. Rezultati i fituar $M = 3.10$ na tregon se ato janë pak mbi mesataren, por jo se arsimi i aftëson plotësisht.

Përveç kësaj, të anketuarit kishin mundësinë të vlerësojnë deri në cilën masë deklarata të caktuara iu referohen atyre. Ajo që është për t'u përsëritur është se 60% e të rinjve kanë mbështetjen e plotë të prindërve të tyre kur përballen me probleme në arsim.

	Definitivisht jo	Në masë të vogël	Në masë të madhe	Plotësisht
Kërkesat e vendosura për mësimdhënie janë një barrë e madhe për mua	29.5	51.4	15	4.1
Ka shumë lëndë që më interesojnë	7.2	26.9	41.7	24.3
Shumica e mësimdhënësve më marrin seriozisht dhe janë të interesuar për punën time	17.8	37.1	30.2	14.9
Shumica e mësimdhënësve u qasen nxënësve në ëmënyrë të duhur	14.8	39.5	33.3	12.5
Rezultatet e shkollës time janë shumë të rëndësishme për prindërit e mi	7.6	20.2	39	33.2
Kam mbështetjen e plotë të prindërve të mi kur përballem me probleme në arsim	3.6	11.7	24.3	60.4


Në këtë drejtim, të anketuarit kishin mundësinë të vlerësojnë se çfarë duhet të ndryshojë në sistemin arsimor. Për gati një të tretën e të rinjve, ndryshimi më i madh duhet të jetë në arsim në drejtim të qasjes praktike të mësimdhënies.

	Përqindja
Kurrikula të gjera	15.1
Mungesa e ushtrimeve/qasjes praktike në mësimdhënie	46.2
Punë kërkimore shkencore që nuk është në përputhje me djersën aktuale	6.3
Mungesa e dialogut në klasë	3.7
Mungesa e bursave, sidomos në arsimin e lartë	6.6
Mungesa e përmbajtjes për shëndetin riprodhues të të rinjve	2.8
Qëndrimi i arsimtarit ndaj nxënësit	7.6
Kapacitetet e arsimtarëve dhe profesorëve	6.2
Pajisjet teknike joadekuate	3.6
Tjetër	1.9

Kur bëhet fjalë për termin Mësimi gjatë gjithë jetës, 82% e të anketuarve thonë se e kanë dëgjuar si term, gjë që vërtet flet për faktin se të rinjtë janë të interesuar të përvetësojnë njohuri.

3.3. POLITIKA E TË RINJVE

Pjesa e tretë e kësaj analize trajton politikat rinore. Të dhënat nga kjo analizë tregojnë se 70% e të rinjve përgjithësisht nuk janë të interesuar për politikë.




Nga ana tjetër, në shkallën prej 1 deri në 5, duke fituar një vlerë mesatare $M = 2.05$, mund të shohim se të rinjtë janë shumë të pakënaqur me cilësinë e masave dhe politikave për të rinjtë (politikat në lidhje me shëndetësinë, arsimin, punësimin, strehimin, kulturën etj.).

Megjithatë, të pyetur se ku mund të ndikojnë më shumë në vendimmarrje, të rinjtë besojnë se mund të kontribuojnë më së shumti përmes organizatave joqeveritare dhe më së paku përmes punës në parti politike dhe kontakteve personale me politikanët.

	M
Puna në parti politike	2.75
Puna në organizata ose shoqata joqeveritare (vullnetare).	3.49
Votimi në zgjedhje	3.30
Kontakti personal me politikanët, dmth. ata që marrin vendime	2.86
Pjesëmarrja në demonstrata publike	3.22
Nënshkrimi i peticioneve	3.23

Gjatë marrjes së vendimeve, të rinjtë kanë ndikimin më të madh në rrethin familjar. Është alarmante informata që në bashkësinë lokale dhe në partitë politike apo OJQ-të, pikëpamjet e tyre pothuajse nuk kanë asnjë ndikim.

	M
Në punë, shkollë apo fakultet	2.02
Në familjen ose amvisërinë tuaj	2.77
Në bashkësinë lokale ku jetoni	1.73
Në organizata politike apo joqeveritare	1.37
Në rrethin e bashkëmoshatarëve dhe miqve ku lëvizni	2.66



17% e të anketuarve nuk kanë të drejtë vote, por nga pjesa e mbetur vetëm 40.5% do të votonin në zgjedhjet e ardhshme lokale. Rrjedhimisht, lind pyetja çka i pengon të rinjtë të marrin pjesë në zgjedhje?

Për përqindjen më të madhe të të rinjve (35%) arsyeja pse ata nuk duan të marrin pjesë në zgjedhje është mungesa e besimit se vota e tyre do të sjellë ndryshime pozitive, si dhe mosinteresi i të rinjve për politikë.

	Përqindja
Të rinjtë nuk janë mjaft të informuar për temat politike	20.7
Mungesa e interesit të të rinjve për politikën	29.1
Programet e partive politike nuk fokusohen sa duhet në nevojat e të rinjve	26.9
Barrierat ligjore (p.sh. Kushtet minimale për moshën, kushtet tjera për regjistrimin e votuesve)	4.0
Mungesa e besimit se vota e tyre do të çojë në ndryshime pozitive	35.3

Si rrjedhojë, lind pyetja pse të rinjtë nuk duan të paraqesin veten si kandidatë për zgjedhje. Për përqindjen më të madhe (26%) është presioni social se ai është shumë i ri për t'u kandiduar, por pothuajse e njëjta përqindje e atyre të rinjve që mendojnë se të rinjtë nuk janë të interesuar për politikën.

	Përqindja
Mungesa e qasjes në informacion (për rregullime ligjore dhe procedurale)	21.2
Mosinteresimi tek të rinjve për politikën	25.1
Mungesa e kapaciteteteve për udhëheqje të fushatës (kohë, financim, bazë për mbështetje)	22.9
Barriera ligjore (kushte minimale për moshë; kushte tjera për regjistrim)	9.6
Mungesa e mundësive për kandidatët e rinj në partitë politike	19.2
Presioni social dhe stigma ("shumë i ri për t'u kandiduar")	26.2

Është shqetësues fakti se vetëm 28.8% e të rinjve janë të njoftuar me ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore dhe vetëm 23% e tyre mendojnë se i njëjti zbatohet në vendbanimin. Gjithashtu, vetëm 19.4% janë të njoftuar me Strategjinë Kombëtare për të rinjtë 2016 - 2025 dhe vetëm 20% e tyre besojnë se e njëjta zbatohet në vendbanimin.

Përqindja më e madhe e të rinjve nuk e dinë nëse ekziston një strategji lokale për të rinjtë në komunën e tyre (më shumë se gjysma e të anketuarve), ndërsa vetëm 11.5% janë të sigurt për ekzistencën e saj. Sipas pjesëmarrësve të fokus grupit, strategjitë lokale për zhvillim pothuajse nuk janë përfshirë në politikën rinore dhe politikën për punësim të të rinjve, se komunat nuk bashkëpunojnë me organizatat rinore për të dëgjuar pikëpamjet e tyre dhe as nuk i marrin seriozisht mendimet dhe pikëpamjet e tyre.

Këto të dhëna plotësohen me faktin se vetëm 20.1% e të anketuarve janë anëtarë të ndonjë organizate joqeveritare kurse 65.3% do të anëtarësoheshin në të ardhmen. Kjo është përqindja e të rinjve që mendojnë se organizatat joqeveritare kanë kapacitetin për të shkaktuar ndryshime shoqërore, edhe atë në një shkallë nga 1 deri në 5, M = 3.18. Vetëm 10% e të rinjve përmendën një organizatë qytetare të caktuar në mjedisin e tyre që punon me të rinjtë dhe ofron punë rinore.


3.4. PJESËMARRJA E TË RINJVE

Pjesa e katërt në këtë Analizë i referohet pjesëmarrjes së të rinjve. Në shkallë nga 1 deri në 5, të rinjtë kishin mundësinë të përgjigjen sa janë të kënaqur me nivelin aktual të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e politikëbërjes për të rinj? Përgjigja e tyre $M = 2.38$, tregon se të rinjtë janë shumë pak të kënaqur me nivelin e pjesëmarrjes.

Vetëm 20.3% e të rinjve në 12 muajt e fundit kanë marrë pjesë në një proces vendimmarrjeje në shkollë, fakultet, komunë apo institucion qeveritar. Përqindja pak më e lartë prej 30.6% e të rinjve kanë shprehur mendimin e tyre në rrjetet sociale në 12 muajt e fundit. Interesante janë përgjigjet e të rinjve lidhur me temat për të cilat kanë shprehur mendimin e tyre, edhe atë më së shpeshti në lidhje me arsimin, mjedisin jetësor, shëndetin mental, shëndetin riprodhues, KOVID dhe vaksinimin.


Të dhënat nga fokus grupet plotësojnë këto të dhëna ku të rinjtë thonë se mundësia për t'u përfshirë në shoqëri dhe për të marrë vendime është sipas vullnetit të lirë, me vetëiniciativë, të rinjtë nuk janë shumë të përfshirë. Nuk ka iniciativa të nxënësve në arsim, megjithëse të rinjtë kanë ide për t'u organizuar.

Megjithatë, vetëm 32.2% e të anketuarve thonë se ka punë vullnetare të organizuar brenda bashkësisë ku ata jetojnë.




Në pyetjen cilat aktivitete janë më të shpeshta, përgjigjet janë pastrimi i mjedisit, ndihma juridike falas, dhurimi i rrobave, ushqimi për të pastrehët, aksionet humanitare, punëtoritë dhe të ngjashme. Ajo që është për t'u përshëndetur është se vetëm 12.3% e të rinjve nuk do të bënin punë vullnetarë nëse do të kishte një mundësi të tillë.

Sa i përket formave ekzistuese të pjesëmarrjes së të rinjve, është alarmant fakti që vetëm 22.9% e të rinjve kanë dëgjuar për këshillat rinore lokale.



Kur përcaktohen këshillat rinore lokale, fitohet përshtypja se ata që kanë dëgjuar për këshillat rinor janë përgjithësisht të informuar për rolin e tyre. Sipas të rinjve, këto janë organe të përbëra nga përfaqësues të formave të ndryshme të organizimit të të rinjve që përfaqësojnë interesat e të rinjve në NJVL; vendet ku diskutohen problemet dhe sfidat e të rinjve në bashkësinë lokale dhe përfaqësohen për zgjidhjen e tyre; të rinjtë nga niveli lokal të cilët duhet të ndikojnë pozitivisht në mjedisin ku jetojnë dhe punojnë ose shkollohen.

Megjithatë, vetëm 20% e të rinjve besojnë se KLR mund të përfaqësojë në mënyrë efektive interesat e të rinjve.



Arsyet për këtë janë se ata i nënshtrohen presioneve të jashtme për shkak të interesave të tjerëve dhe mbështeten me mjete financiare dhe për këtë arsye nuk përfaqësojnë interesat **në mënyrë më efektive**, sepse tek të moshuarit ekziston ende dyshimi se të rinjtë nuk mundën dhe nuk dijnë të sjellin vendime.

3.5. SIGURIA

Pjesa e fundit e kësaj Analize i referohet sigurisë së të rinjve. Mund të vërejmë se të rinjtë ndihen më pak të sigurt në internet dhe më të sigurt në shtëpi.

	M
Në shtëpi	4.62
Në shkollë / fakultet	3.97
Në lagje	3.84
Në internet	2.72

Ajo që i bën të rinjtë të ndihen të pasigurt janë kryesisht qentë endacakë në mjedisin lokal.

	Përqindja
prania e dhunës	16.0
fqinjët e pasjellshëm	9.3
shumë makina	9.8
qentë endacak	22.8
Mungesa e ndriçimit rrugor	14.0
Ndihem i sigurt në vendbanimin tim	15.6


16.7% e të rinjve të anketuar kanë theksuar se kanë qenë viktimë e dhunës. Më shpesh, të rinjtë tregojnë se janë sulmuar fizikisht në oborrin e shkollës ose në mjedisin ku jetojnë, maltretim nga bashkëmoshatarët, dhunë në internet dhe ngacmim psikologjik.

Nga ana tjetër, 44.3% e të rinjve pjesë e kësaj ankete thonë se njohin dikë që ka qenë viktimë e dhunës, më së shpeshti në formë të bullizmit, dhunës verbale, dhunës fizike në oborrin e shkollës, por fatkeqësisht edhe dhunës në familje. Megjithatë, vetëm 14.3% e të rinjve kanë raportuar dhunë. Ndoshta arsyeja është se të rinjtë nuk kanë besim te institucionet.

Sipas të dhënave të fokus grupeve, të rinjtë që jetojnë në vende të vogla dhe njëetnike kanë më pak gjasa të ekspozohen ndaj sjelljeve të dhunshme sesa ata që jetojnë në vende më të mëdha. Megjithatë, të rinjtë besojnë se bota virtuale është një rrezik më i madh, veçanërisht në kohë pandemie, kur shumica e të rinjve e kalojnë kohën e lirë në internet.

4. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KAPACITETEVE DHE QËNDRIMEVE TË ORGANIZATAVE QYTETARE

Në suaza të këtij hulumtimi gjithashtu u realizua vlerësimi i kapaciteteve të OJQ-ve rinore si dhe qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre për trendet shoqërore që lidhen me rininë. Përmes pyetësorit anketues u përfshin 61 organizata, nga të cilat më shumë se gjysma (57.4%) janë organizata joqeveritare të fokusuara në çështjet rinore, dhe vetëm 3.3% janë organizata ombrellë rinore.



Për më tepër, në suaza të Analizës nën «Tjetër» janë përfshirë organizata që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, shoqata që punojnë me grupet e marginalizuara, përfaqësimi i të rinjve, çështjet gjinore, çështjet lidhur me shëndetin.

Përqindja më e madhe (47,5%) e organizatave janë të vendosura në Shkup.

Shkup	29	47.5
Kumanovë	1	1.6
Tetovë	3	4.9
Gostivar	2	3.3
Dibër	1	1.6
